

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Avdi Dinaj-kryetar i kolegjit, Nesrin Lushta, Emine Mustafa, Marije Ademi e Salih Toplica-anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Arben Ismajli-proçesmbajtës, në çështjen penale e të akuzuarit F. K. nga fshati A. komuna e Malishevës, për shkak të veprave penale vrasje në tentativë nga neni 146. lidhur me nenin 20. të KPK dhe mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328. par. 2. të KPK, duke vendosur sipas ankesave të Prokurorit publik të qarkut në Prizren, të përfaqësuesit të e dëmtuarit dhe të mbrojtësit të të akuzuarit, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr. 176/2010 të datës 04.10.2011., në seancën e mbajtur konform nenit 410. të KPPK, më datën 18.04.2012., mori këtë:

A K T G J Y K I M

I Me aprovimin e ankesës së Prokurorit publik të qarkut në Prizren dhe të përfaqësuesit e të dëmtuarit F. B., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së qarkut në Prizren P.nr.176/2010 i datës 04.10.2011. përkitazi me vendimin për dënimin ashtu që Gjykata Supreme, për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 146. lidhur me nenin 20. të KPK të akuzuarit F. K. i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 31.12.2009. deri më datën 26.02.2010., dhe në arrestin shtëpiak prej datës 26.02.2010. deri më datën 29.05.2010.

II Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit hedhet si e paafatshme.

III Në pjesën që ka të bëjë me veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328. par. 2. të KPK, aktgjykimi ngel i paprekur.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.176/2010 të datës 04.10.2011. i akuzuari F. K. është shpallur fajtor për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 146. lidhur me nenin 20. të KPK dhe është gjykuar me dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 31.12.2009. deri më datën 26.02.2010., dhe në arrestin shtëpiak prej datës 26.02.2010. deri më datën 29.05.2010. I akuzuari është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200 €, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. Për realizimin e kërkesës pronësoro juridike i dëmtuari është udhëzuar në kontestin civil.

Me të njëjtin aktgjykim, ndaj të akuzuarit F. K. është refuzuar aktakuza për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328. par. 2. të KPK, pasi që prokurori publik ka heqë dorë nga aktakuza.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesa kanë ushtruar:

- Prokurori publik i qarkut në Prizren, sa i përket veprës penale vrasje në tentativë, për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që

aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit të shqiptohet dënim më i ashpër,

- përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit F. B., avokati D. J. nga Prizreni, po ashtu për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit të shqiptohet dënim më i ashpër dhe

- mbrojtësi i të akuzuarit, avokati I. E. nga Malisheva, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi të ndryshohet ashtu që të akuzuarit të shqiptohet një dënim më i butë.

Prokurori i shtetit, me parashtresën PPA.nr.483/2011 të datës 21.12.2011. ka propozuar që ankesa e Prokurorit publik të qarkut në Prizren dhe ajo e përfaqësuesit të të dëmtuarit të aprovohen ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Edhe pse të njoftuar me rregull palët dhe mbrojtësi i të akuzuarit nuk prezantuan në seancë, ashtu që në kuptim të nenit 410. par. 4. të KPPK seanca u mbajt pa praninë e tyre.

Në seancë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës bashkë me ankesat e paraqitura dhe propozimit e Prokurorit të shtetit dhe pasi që aktgjykimi i ankimuar u studiuua sipas detyrës zyrtare konform nenit 415.par. 1. të KPPK u gjet se:

-ankesa e mbrojtësit të akuzuarit është e pa afatshme ndërsa ankesat e Prokurorit publik të qarkut në Prizren dhe ajo e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit janë të bazuara.

Konform dispozitës së nenit 398. par. 1. të KPPK kundër aktgjykimit të marrë në shkallë të parë, afati për ushtrimin e ankesës është 15 ditë nga dita e pranimit të aktgjykimit, ndërsa konform dispozitës së nenit 127. par. 4. të KPPK, në qoftë se i pandehuri ka mbrojtës, shkresa nga paragrafi 2. i këtij neni (aktakuza, propozim akuza, padia private, aktgjykimi dhe vendimet tjera për të cilat afati i ankesës fillon nga dita e dorëzimit) i dërgohet mbrojtësit dhe të pandehurit dhe në rastin e tillë afati për ushtrimin e mjetit juridik ec nga dita e dorëzimit të shkresës të pandehurit.

Nga fletë dorëzimi konstatohet se të akuzuarit aktgjykimi i ankimuar është dorëzuar më datën 05.11.2011, ndërsa nga vula e pranimit të ankesës në gjykatë, vërtetohet se ankesa e mbrojtësit është dorëzuar më datën 22.11.2011.

Pasi që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit është ushtruar pas kalimit të afatit ligjor, konform dispozitës së nenit 421. të KPPK u vendos që te hedhet si e pa afatshme.

Aktgjykimi i shkallës së parë u shqyrtua në pjesën në të cilën goditet me ankesat e Prokurorit publik të qarkut në Prizren dhe të përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit, por Gjykata Supreme paraprakisht, konform dispozitës së nenit 415. par. 1. të KPPK shqyrtojë ekzistimin e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe të ligjit penal të cilat shqyrtohen detyrimisht dhe gjeti se nuk ekzistojnë.

Nga aktgjykimi i ankimuar del se me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat nga neni 64. të KPK dhe me këtë rast si rrethana rënduese ka marrë faktet se për shkak të mosmarrëveshjeve paraprake me të dëmtuarin, i akuzuari paraprakisht është përgatitur për vepër penale, mënyrën e kryerjes së të njëjtës, sepse ka marrë edhe disa persona tjerë dhe është

armatosur dhe pasojat e veprës penale, ndërsa si lehtësuese se i akuzuari ka pas sjellje korrekte pas kryerjes së veprës penale, ka pranuar kryerjen e saj, është penduar dhe ka kërkuar falje nga i dëmtari, se është i ri dhe se ekzistojnë orvatjet për pajtimin me familjen e të dëmtuarit.

Prokurori publik i qarkut në ankesë ka theksuar se nuk janë çmuar në mënyrë adekuate rrethanat e rastit konkret, sidomos pesha e rëndë e veprës penale, gjegjësisht pasoja e shkaktuar, sepse i dëmtuari i cili ka pësuar lëndime të rënda trupore ende është duke u shëruar, ndërsa marrëdhëniet në mes dy familjeve janë të tendosura. Edhe në ankesën e përfaqësuesit të të dëmtuarit ceket se nuk janë vlerësuar rrethanat në të cilat vepra penale është kryer, pasi që i akuzuari ka marrë edhe katër persona me vete dhe me automjet e ka qëlluar automjetin e të dëmtuarit, duke e përplasur në hendek e pastaj e ka sulmuar, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, pasojat e së cilave ende nuk janë shëruar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, ankesat janë të bazuara sepse i akuzuari ka shprehur shkallë më lartë të përgjegjësisë penale se ka gjetur gjykata e shkallës së parë, ndërsa edhe rrezikshmëria shoqërore e veprës penale është e madhe për shkak të mënyrës së kryerjes së saj dhe pasojave të shkaktuara, siç drejt ceket në ankesat e paraqitura. Andaj, drejt pretendohet në ankesa se rrethanat e përshkruara nuk janë çmuar në mënyrë adekuate dhe se ato tregojnë se për arritjen e qëllimit të dënimit nga neni 34. të KPK është e domosdoshme që të akuzuarit të shqiptohet dënim më i lartë.

Nga sa u tha, në bazë të nenin 421. të KPPK ankesa e mbrojtësit të akuzuarit u hedh si e palejuar, ndërsa në bazë të nenit 426. të KPPK aktgjykimi sa i përket veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146.

lidhur me nenin 20. të KPK u ndryshua për vendimin për dënimin, sikur në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328. par. 2. të KPK nuk ishte i ankimuar, për çka ngeli i paprekur.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
AP.nr. 483/2011, më 18.04.2012.

PROCESMBAJTËSI
Arben Ismajli

KRYETARI I KOLEGJIT
Avdi Dinaj

ANTARËT E KOLEGJIT

Nesrin Lushta _____

Emine Mustafa_____

Marije Ademi_____

Salih Toplica_____